

**VENDIM**  
**Nr.32, datë 9.7.2007**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                        |                                |
|------------------------|--------------------------------|
| Gjergji Sauli          | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Alfred Karamuço Anëtar | i “ “                          |
| Fehmi Abdiu            | Anëtar i “ “                   |
| Kristofor Peçi         | Anëtar i “ “                   |
| Vjollca Meçaj          | Anëtare e “ “                  |
| Xhezair Zaganjori      | Anëtar i “ “                   |
| Petrit Plloçi          | Anëtar i “ “                   |
| Sokol Sadushi          | Anëtar i “ “                   |
| Kujtim Puto            | Anëtar i “ “                   |

me sekretare Blerina Çinari, në datën 26.2.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA “REXHEPI” SHPK, TIRANË, përfaqësuar nga Fatmira Luli, me prokurë.  
SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. BASHKIA TIRANË, përfaqësuar nga Migena Vishko, me autorizim.
2. KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT PRANË BASHKISË TIRANË, përfaqësuar nga Migena Vishko dhe avokati i shtetit Dhimitraq Konini, me autorizim.

3. SHOQËRIA “TID” SHPK, përfaqësuar nga avokati Dashamir Kore, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.600, datë 12.5.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe nr.511, datë 14.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, duke pretenduar se vendimet e mësipërme të gjykatave janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- I është mohuar e drejta e aksesit në gjykatë me arsyetimin e kundërligjshëm se vendimi i KRRT-së të Bashkisë është shfuqizuar nga KRRTRSH-ja. Ndërhyrja e pushtetit ekzekutiv në veprimtarinë gjyqësore përbën gjithashtu cenim të parimit të gjykatës së pavarur.

- Gjykata e apelit është treguar e njëanshme sepse ka pranuar ankimin e subjektit të interesuar “TID” SHPK në kundërshtim me kërkesat e nenit 453 të Kodit të Procedurës Civile për elementet e ankimit, si dhe ka rrëzuar kërkesën e kërkuarit për përjashtimin e trupit gjykues.

- Në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, gjykata e apelit e ka konsideruar vendimin e KRRTRSH-së si një akt relativisht të pavlefshëm që duhet të goditet me padi të veçantë, dhe jo si një akt absolutisht i pavlefshëm.

- Vendimi i gjykatës së apelit bazohet pa të drejtë në një vendim tjetër gjyqësor, i cili është i pavlefshëm për kërkuarin jo vetëm se është dhënë pa qenë palë pronarët e truallit, por edhe se nuk ka ndryshuar pronësinë, por vetëm ka përcaktuar konkretisht kufijtë.

Subjektet e interesuara kanë paraqitur këto shkaqe për rrëzimin e kërkesës:

- Gjykata Kushtetuese nuk mund të shfuqizojë vendimin e Gjykatës së Lartë për seleksionimin e çështjes përse kohë nuk konstaton se nga ky vendim preket një e drejtë kushtetuese.

- Gjykata e apelit nuk ka injoruar pretendimet e kërkuarit, por u ka dhënë përgjigje me vendim të arsyetuar duke respektuar parimin e kontradiktoritetit.

- Pretendimet e kërkuarit lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat për thelbin e çështjes dhe nuk përbëjnë objekt shqyrtimi nga juridiksioni kushtetues.

- Vendimi i KRRTRSH-së nuk është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesen e kërkuarit, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesë dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Tiranë (KRRT), me vendimin nr.587, datë 26.11.1997, ka miratuar lejen e sheshit për ndërtimin e dy godinave në favor të kërkuarit, SHPK “Rexhepi”, në

truallin në pronësi të familjeve “Berliku” e “Shameti”, dhe me vendimet nr.684, datë 22.12.1997 e nr.505, datë 24.8.1998, ka dhënë lejet përkatëse të ndërtimit.

Këshilli i Rregullimit të Territorit Tiranë, me vendimin nr.175, datë 9.5.2003, ka miratuar shesh ndërtimi, ndërsa me vendimin nr.269, datë 28.5.2004, ka miratuar lejen e ndërtimit në favor të subjektit të interesuar Shoqëria “TID” sh.p.k., në truallin që sipas këtyre vendimeve është në pronësi të familjeve “Alla”, “Toska” e “Kondo”, ndërsa sipas pretendimeve të kërkuarit është në pronësi të familjeve “Berliku” e “Shameti”.

Pas miratimit të vendimeve të mësipërme, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH), në mbledhjen e datës 11.9.2004, vendosi shfuqizimin e vendimeve të KRRT-së të Bashkisë Tiranë për lejet e sheshit dhe të ndërtimit, të dhëna në favor të kërkuarit.

Kërkuari, SHPK “Rexhepi”, kërkoj me padi në gjykatë anulimin e vendimeve të KRRT-së të Bashkisë të dhëna në favor të Shoqërisë “TID” sh.p.k. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.320, datë 27.1.2005, vendosi anulimin e këtyre vendimeve.

Pas ankimit të subjektit të interesuar, Shoqërisë “TID” sh.p.k. dhe të Bashkisë Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.600, datë 12.5.2005, vendosi ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe rrëzimin e padisë së kërkuarit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), me vendimin nr.511, datë 14.4.2006, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është e drejtë kushtetuese e individit që lidhet me rregullsinë e procesit në sistemin gjyqësor. Por, duke zbatuar kompetencën e saj për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e kësaj të drejte, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta shtrijë kontrollin e saj mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse kjo i takon juridiksionit gjyqësor. Në shqyrtimin e ankesave për shkelje të tilla, kjo Gjykatë kontrollon nëse janë respektuar nga gjykatat e sistemit gjyqësor parimet themelore të procesit sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në çështjen në shqyrtim Gjykata Kushtetuese nuk konstaton cenim të këtyre parimeve themelore.

Kërkuari pretendon se atij i është mohuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi gjykata e apelit ka arritur në përfundimin që ai përpara se të kërkonte anulimin e vendimit të KRRT-së të Bashkisë të dhënë në favor të Shoqërisë “TID” sh.p.k. duhet të kundërshtonte në gjykatë vendimet e KRRTRSH-së, me të cilat janë anuluar vendimet e dhëna në favor të tij.

Gjykata e apelit, në vendimin e saj, nuk e konsideron si një akt absolutisht të pavlefshëm vendimin e datës 11.9.2004 të KRRTRSH-së. Ajo gjykatë arsyeton se vendimi i KRRTRSH-së i përmbush kushtet për të mos u konsideruar një akt absolutisht i pavlefshëm, pasi organi që ka nxjerrë aktin, pra KRRTRSH-ja, është i identifikuar dhe ka vepruar sipas kompetencave të veta. Ajo pranon gjithashtu që akti i saj është nxjerrë sipas formës së kërkuar nga ligji. Duke pranuar se ky vendim nuk është absolutisht i pavlefshëm, gjykata e apelit ka pranuar njëkohësisht që ai mund të kundërshtohet brenda afatit 30-ditor vetëm për pavlefshmëri relative dhe kjo mund të bëhet me një proces të veçantë gjyqësor.

Vlerësimi nëse akti i lartpërmendur është absolutisht apo relativisht i pavlefshëm, rezulton nga analiza që gjykata e apelit i ka bërë rrethanave të çështjes, vlerësimit të formës dhe të përmbajtjes së aktit e kompetencave të organit që e ka nxjerrë, si dhe nga interpretimi i dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Jo vetëm kaq, por ndryshe nga sa pretendon kërkuari, gjykata e apelit nuk ka çmuar vetëm legjitimitimin e kërkuarit, sepse ajo nuk është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e konkluzionit për vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e aktit. Ajo i është futur edhe problemeve të themelit. Kështu, gjykata ka bërë analizën e provave, që lidhen me pronësinë e truallit në konflikt, vendndodhjen e këtij trualli, ka vlerësuar juridiksionin e gjykatës në raport me atë të KRRTRSH-së, pra ka analizuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka konkluduar se trualli në mosmarrëveshje nuk i takon familjeve me të cilat ka lidhur kontratë për ndërtim kërkuari, por familjeve që kanë lidhur kontratë me subjektin e interesuar.

Në çështjen në shqyrtim, gjykata e apelit i ka lejuar palët të paraqesin pretendimet e tyre për të gjitha problemet e themelit dhe ka nxjerrë konkluzionet e veta. Shqyrtimi dhe zgjidhja e çështjes në bazë të analizës së provave dhe interpretimit të dispozitave ligjore është kompetencë e gjykatave të sistemit gjyqësor, sepse dhënia e drejtësisë është atribut i këtyre gjykatave. Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëjë vlerësim tjetër të ndryshëm nga vlerësimi i provave dhe interpretimi i ligjit që kanë bërë gjykatat e sistemit gjyqësor, nëse ky interpretim nuk cenon elementët thelbësorë të një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

Kërkuari ka pretenduar gjithashtu se gjykata e apelit ka cenuar parimin e barazisë së armëve në gjykim, duke e argumentuar këtë pretendim me refuzimet e kërkesave të tij për pezullimin e gjykimit deri në përfundim të çështjes penale për falsifikimet e pretenduara të vendimit të KRRT-së të Bashkisë, si dhe me kërkesat për përjashtimin e relatorit nga gjykimi dhe për mospranimin si të parregullt të ankimit të Shoqërisë “TID” sh.p.k.

Pretendimet e mësipërme të kërkuarit nuk janë të tilla që të përbëjnë cenim të parimit të barazisë së armëve. Barazia e armëve apo e mjeteve nënkupton që çdokush “që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë pretendimet e provat e veta, që asnjë prej palëve nuk duhet të favorizohet në gjykim në

raport me palën tjetër dhe që secila prej tyre të ketë njohuri mbi pretendimet e provat e palës tjetër”.<sup>1</sup>

Në çështjen në shqyrtim, nuk konstatohet që palët të jenë vënë në pozita të disfavorshme.

Duke respektuar kërkesat e Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit ka dëgjuar kërkesat e argumentet e palëve në gjykim. Ajo ka çmuar rëndësinë që kishte për gjykimin e çështjes civile hetimi penal i akuzës për falsifikim të vendimit të KRRT-së të Bashkisë. Ky vlerësim ishte kompetencë e vet gjykatës që gjykonte çështjen. Ajo sipas kompetencave të veta çmoi gjithashtu se nuk mund të përjashtohet relatori i çështjes nga gjykimi vetëm se nuk u pranua kërkesa për pezullim. Përsa i përket ankimit të paraqitur me nënshkrimin e avokatit që nuk ishte i pajisur me prokurë, gjykata e apelit pasi dëgjoi pretendimet e palëve dhe bëri verifikimet përkatëse konstatoi se veç shoqërisë “TID” sh.p.k. kishte bërë ankim me të njëjtat shkaqe edhe Bashkia Tiranë, që ishte palë tjetër e paditur në çështje dhe duke verifikuar në seancë gjyqësore edhe vullnetin e shoqërisë “TID” sh.p.k. në lidhje me ankimin, nxorri konkluzionet e veta pa i cenuar ndonjë të drejtë kërkuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### MENDIMI I PAKICËS

Nuk jemi dakord me mendimin e shumicës.

Shkaqet e pretenduara nga kërkuarja dhe që u vërtetuan gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, përbëjnë elemente të një procesi jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se vendimi i KRRTSH-së, me të cilin janë shfuqizuar vendimet e KRRT-së të Bashkisë për shesh dhe leje ndërtimi në favor të kërkuarit (Shoqëria “Rexhepi”) janë marrë në kohën që ishte në gjykim padia e këtij të fundit me objekt anulimin e lejeve të ndërtimit për të njëjtën sipërfaqe toke të dhëna nga KRRT-ja e Bashkisë në favor të subjektit të interesuar “TID” sh.p.k. Megjithatë, gjykata e apelit u bazua te vendimi i KRRTSH-së dhe ndryshoi vendimin e gjykatës së rrethit duke rrëzuar padinë e kërkuarit. Megjithatë çështja e lejeve të ndërtimit në të njëjtin truall ishte në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, shqyrtimi i kërkesës për anulimin e lejeve të ndërtimit të dhëna në favor të kërkuarit nuk i takonte juridiksionit administrativ, por atij gjyqësor dhe kapërcimi i kufijve të këtij juridiksioni përbën element të procesit jo të rregullt ligjor. Jo vetëm kaq, por zgjidhja e çështjes nga gjykata e apelit është bërë duke u bazuar te ky vendim i KRRTSH-së dhe kjo vjen në kundërshtim me nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, i cili edhe për të mbrojtur pavarësinë e gjykatave thekson se “asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata” dhe se “është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë”.

Gjykata e apelit ka pranuar si të mirëqenë pretendimin e subjektit të interesuar, sipas të cilit pronësia mbi sheshin e ndërtimit nuk i takon familjeve me të cilat ka lidhur kontratë sipërmarrje kërkuarja, por e familjeve me të cilat ka lidhur kontratë subjekti i interesuar. Është e vërtetë që nxjerrja e konkluzioneve për provat është kompetencë e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe e gjykatës së apelit, por megjithatë, ky vlerësim kur bëhet në mënyrë arbitrare e të njëanshme, të çon në cenimin e parimit të procesit të rregullt ligjor. Në çështjen në shqyrtim, përcaktimi i pronësisë së truallit kishte rëndësi kryesore dhe në kushtet kur eksperti përcaktoi mbivendosje, gjykata e apelit që pranoi një konkluzion të kundërt duhet të argumentonte në mënyrë korrekte, pra duke u bazuar në prova, konkluzionin e kundërt me ekspertin dhe dokumentacionin e dosjes për pronësinë e truallit të dhënë për ndërtim. Parimi i barazisë së palëve në gjykim kërkon që jo vetëm secila palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta për të paraqitur pretendimet e veta, por edhe që gjykata në vendimin e saj, pa favorizuar asnjë prej tyre, t’u japë përgjigje pretendimeve të ngritura.

Anëtarë: K. Puto, Gj. Sauli

<sup>1</sup> Borges kundër Belgjikës, 30 tetor 1991, paragrafi 24